

Qeveria e Kosovës
Vlada Kosova - Government of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarija za Dobro Upravljanje / Office on Good Governance



RAPORT VJETOR PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR ORGANIZATAT JO-QEVERITARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS PËR VITIN 2023

MAJ 2024

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE 3

1.HYRJE 5

1.1 Metodologjia e përdorur 6

2.TË DHËNA E PËRGJITHSHME PËR RAPORTIM NGA ANA E ORGANIZATAVE BUXHETORE 7

2.1 . Raportimi nga Organizatat Buxhetore7

2.2 Të dhëna mbi raportimin sipas secilës nga Organizatat Buxhetore 11

3.TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË NË NIVEL TË MINISTRIVE, KOMUNAVE DHE AGJENCIVE TJERA TË PAVARURA 14

4.TË DHËNA PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË SIPAS MINISTRIVE, KOMUNAVE DHE AGJENCIVE TJERA 24

4.1 Të dhënat e përgjithshme për Financimin Publik të OJQ-ve për vitin 2023 sipas raportimit nga Institucionet Publike/Organizatave buxhetore 24

4.2 Mbështetja Financiare për OJQ-të në kuadër të MINISTRIVE për vitin 2023 26

4.2.1 Numri i projekteve dhe shumat e mbështetjes financiare për OJQ-të përfituese nga përkrahja financiare e Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive Error! Bookmark not defined.

4.2.3 Analizë e thirrjeve publike në nivel të Ministrive 29

5.Mbështetja në kuadër të KOMUNAVE 30

5.1. Analizë e Thirrjeve Publike në nivel të Komunave Error! Bookmark not defined.

5.2 Numri i OJQ-ve përfituese nga Financimi i komunave dhe ndarja sipas shumave të mbështetjes financiare 31

6.KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME 32

7.ANEKSE: LISTA E PËRFITUESVE SIPAS INSTITUCIONEVE DHE SHUMA E MBËSHTETJES FINANCIARE PUBLIKE PËR VITIN 2023 37

7.1 LISTA E OJQ-VE PËRFITUESE NGA MBËSHTETJA FINANCIARE PUBLIKE NË KUADËR TË MINISTRIVE TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2023 37

7.2 LISTA E OJQ-VE PËRFITUESE NGA MBËSHTETJA FINANCIARE PUBLIKE NË KUADËR TË KOMUNAVE TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2023

7.3 LISTA E OJQ-VE PËRFITUESE NGA DONATORET PËR VITIN 2023 82

LISTA E SHKURTESAVE

- | | |
|-----------|---|
| 1. ZKM | ZYRA E KRYEMINISTRIT |
| 2. MPB | MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME |
| 3. MAPL | MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL |
| 4. MASHTI | MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT |
| 5. MBPZHR | MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL |
| 6. MD | MINISTRIA E DREJTËSISË |
| 7. MFPT | MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE |
| 8. MM | MINISTRIA E MBROJTJES |
| 9. ME | MINISTRIA E EKONOMISË |
| 10. MKK | MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM |
| 11. MKRS | MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT |
| 12. MMPH | MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR |
| 13. MPJD | MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS |
| 14. MSH | MINISTRIA E SHËNDETËSISË |
| 15. MINT | MINISTRIA E INDUSTRIISË NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË |
| 16. MZHR | MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL |
| 17. OJQ | ORGANIZATA JO-QEVERITARE |

Fjalë hyrëse

Të nderuar/a

Rutina e publikimit të raportit vjetor për mbështetjen financiare publike për organizatat jo qeveritare në Republikën e Kosovës, pa dyshim, që është sukses i jashtëzakonshëm institucional. Në vitin 2023 krahas publikimit të këtij Raporti, avancimit të platformës online të financimit publik të OJQ-ve, ne si institucione kemi pasur edhe zhvillime tjera pozitive, progres dhe sukses të veçantë drejt rritjes së transparencës së institucioneve publike në fushën e financimit publik të OJQ-ve.

Në këtë përmbledhje të raportit vjetor për financimin publik të OJQ-ve, duam të pasqyrojmë progresin dhe rezultatet e arritura gjatë vitit të kaluar. Nëpërmjet përdorimit të burimeve financiare në mënyrë të zgjuar dhe transparente, kemi arritur të implementojmë projekte dhe programe që kanë ndikuar drejtë për drejtë në ndryshimin e përparuar të komunitetit tonë.

Në këtë përmbledhje analizojmë burimet financiare të disponueshme dhe të shpërndara për OJQ-të si dhe se si këto burime janë shfrytëzuar për të mbështetur misionin dhe programet e tyre. Në veçanti, vlerësojmë impaktin e projekteve dhe programeve të financuara duke theksuar ndikimin në komunitet dhe aftësinë e institucioneve tona për të adresuar sfidat aktuale në mjedisin tonë operativ. Përmes këtij prezantimi, demonstrojmë përgjegjësinë dhe përpjekjet tona për të ndikuar në zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të qytetarëve tanë. Gjithashtu, prezantojmë parashikimet për të ardhmen dhe strategjitë tona për të përmbushur qëllimet tona të përbashkëta me OJQ-të. Sfidat janë të shumta, por ne jemi të përkushtuar për të adresuar ato me qëllime dhe strategji të qëndrueshme për të ardhmen.

Faleminderit për përkrahjen dhe bashkëpunimin tuaj në këtë rrugë të vazhdueshme të shërbimit dhe ndryshimit pozitiv në shoqëri.

Sinqerisht,

Habit Hajredini, Drejtor, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit

1. HYRJE

Raporti vjetor për financimin publik të organizatave joqeveritare (OJQ) ofron një pasqyrë të detajuar të burimeve financiare për organizatat joqeveritare nga institucionet publike, duke përfshirë ministrinë dhe komunat, në përputhje me Rregulloren e MF.Nr.04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, e cila buron nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit bashkë me Ministrinë e Financave, me bazë të Rregullorja MF-Nr.04/2017 Kosova ka ndërtuar një sistem me rregulla unike sa i përket financimit publik të OJQ-ve, rregulla këto të cilat përcaktojnë kriteret minimale të ndërlidhura me financimin publik të OJQ-ve. Rregullorja MF-Nr. 04/2017 krahas obligimeve tjera përcakton në mënyrë të detajuar përgjegjësinë që institucionet publike kanë për raportimin lidhur me financimin publik të OJQ-ve. Rregullorja synon unifikimin e procedurave për gjithë ciklin e financimit publik të OJQ-ve, duke përfshirë, planifikimin, thirrjet publike, kontraktimin, monitorimin dhe raportimin e këtij financimi.

Gjatë vitit të kaluar, financimi është përdorur për të mbështetur projekte dhe aktivitete të ndryshme që kanë për qëllim të promovojnë zhvillimin dhe mirëqenien në shoqëri. Përmbledhja e raportit prezanton informacionin kryesor në lidhje me shumën e financimit, organizatën buxhetore dhe atë përfutur, sektorët e ndikimit të projekteve të mbështetura, si dhe rezultatet e arritura. Kjo pasqyrë e financimit është e rëndësishme për të vlerësuar ndikimin dhe efikasitetin e investimeve publike në OJQ dhe për të përcaktuar nevojat dhe prioritetet për vitin e ardhshëm. Pra, raporti mbulon përkrahjen e Organizatave Jo-Qeveritare nga të gjitha organizatat buxhetore qeveritare të nivelit qendror dhe lokal në fusha të ndryshme të cilat janë të ndërlidhura me prioritet e Institucioneve të Republikës së Kosovës.

Procesi i raportimit për financimin e OJQ-ve është avancuar në vazhdimësi, pra jo vetëm duke e krijuar dhe lansuar platformën për financim, por duke u zhvilluar deri në atë nivel sa e është mundur edhe raportimi direkt institucional në platformën për financim publik të OJQ-ve <http://ojqfinancime.rks-gov.net>

Në platformën online mund të gjenden të dhënat për mbështetjen financiare publike për OSHC-të sipas viteve, institucioneve, OJQ-ve, regjioneve, fushave etj. Ky proces është avancuar gjatë gjithë kohës, pra, përderisa në vitin 2020 është krijuar dhe lansuar platforma <http://ojqfinancime.rks-gov.net> e cila ka mundur të rritet transparenca në financimin e projekteve të OJQ-ve, tani ekziston mundësia për tu publikuar më shumë të dhëna për projektet e financuara nga ana e autoriteteve publike.

Raporti për financimin e organizatave Jo-qeveritare nga institucionet për vitin 2023 përfshin një gamë të gjerë të informacionit që synon të sigurojë transparençë dhe llogaridhënsi ndaj publikut, mbështetësve, autoriteteve përgjegjëse e edhe donatorëve tjerë. Kjo përfshin publikimin e informacionit financiar në mënyrë të qartë dhe lehtësishtë të kuptueshme për të gjitha palët e interesuara. Për më shumë detaje lidhur me raportimin e financimit të OJQ-ve specifike nga të gjitha organizatat buxhetore të caktuar dhe parimet e llogaridhënjes bazohemi të rregullat që i ka përcaktuar Rregullorja MF.Nr.04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Ky raport ka për qëllim jo vetëm rritjen e transparençës dhe llogaridhënie së institucioneve publike, por po ashtu edhe krijimin e besimit të ndërsjellë në mes të institucioneve publike dhe shoqërisë civile.

Prandaj, publikimi i vazhdueshëm i raporteve vjetore për mbështetjen financiare publike për OJQ-të ka dhënë efektet e veta pozitive në përmirësimin e zbatueshmerisë së rregullativës ligjore që mbulon fushën e financimit publik të OJQ-ve në Republikën e Kosovës.

Raporti për financimin publik të OJQ-ve për vitin 2023 nga ana e Organizatave Buxhetore pasqyron një përmirësim shumë të dukshëm të gjendjes, sepse ky raport gjithëpërfshirës është shumë më i kompletuar sa i përket të gjitha procedurave të ndarjes së fondeve publike duke filluar nga planifikimi, thirrja e deri të raportimi direkt në platformë i organizatave buxhetore për fondet publike për OJQ-të.

Raporti i vitit 2023 përmbledh në vete raportimin nga pothuaj gati të gjitha ministrinë, pra janë 15 ministrinë dhe Zyra e Kryeministrit me katër zyra në kuadër të saj që kanë raportuar për financimin publik të OJQ-ve për vitin 2023. Katër prej këtyre ministrive kanë raportuar se nuk kanë përkrahur OJQ, ndërsa njëmbëdhjetë të tjerat kanë raportuar në platformë. Gjithashtu janë katër zyra nga ZKM që kanë raportuar për ndarjen e fondeve për OJQ-të (dy prej tyre kanë raportuar në platformë, një ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ dhe një tjetër se kanë përkrahur OJQ me më pak se 500 euro). Ndërsa prej 38 komunave të Republikës së Kosovës, janë 31 komuna të cilat kanë raportuar në platformën për financim publik <http://ojqfinancime.rks-gov.net/> për fondet që i kanë ndarë për OJQ-të dhe janë 07 komuna nga to të cilat nuk kanë raportuar.

Publikimi i këtij raporti vlerësojmë se jo vetëm që do të kontribuojë rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike por në të njëjtën kohë do të ketë ndikim në përmirësimin e bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile në Republikën e Kosovës.

Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit ka punuar dhe i ka përkrahur shumë zyrtarët nga shumë Institucione Qeveritare/Organizata Buxhetore në nivelin qendror e lokal për të ju ndihmuar dhe forcuar kapacitetet e tyre në pergaditjen e raportit dhe implementimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

Shfrytëzojmë rastin që në emër të Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit të falënderojmë të gjitha institucionet publike për përkrahjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm në këtë proces si dhe në të njëjtën kohë kërkojmë përkushtimin dhe bashkëpunimin e tyre edhe më të madh në të ardhmen.

1.1 Metodologjia e përdorur

Pra, ashtu si edhe u theksu me lartë Zyra e Kryeministrit /Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Ministria e Financave tashmë kanë krijuar një sistem transparent dhe të përgjegjshëm për financimin e Organizatave të Shoqërisë Civile. Rrjedhimisht transparencën për ndarjen e fondeve publike për OShC-të dhe përgjegjshmërinë e institucioneve për ndarjen e këtyre fondeve e kemi forcuar më shumë me përditësimin dhe avancimin e Platformës Online për Financim Publik të OJQ-ve <http://ojqfinancime.rks-gov.net/>. Kjo patjetër që po kontribuon në rritjen e besimit të publikut në institucionet publike dhe partneritetin me organizatat e shoqërisë civile. Gjithashtu kjo besojmë se do të frymëzoj qytetarët që të bëhen edhe më aktiv, të jenë pjesë të këtij procesi dhe të kontribuojnë në dobi të komunitetit dhe këtij bashkëpunimi.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në përputhje me kërkesat e Rregullores, MF-Nr. 04/2017, bashkë me zyrtarët përgjegjës për këtë proces që janë caktuar nga secila organizatë

buxhetore për Zyrën e Kryeministrit, pra, të gjitha ministritë si dhe pothuajse të gjitha komunat përgjegjëse, janë pjesë e procesit të finalizimit të këtij raporti.

Të gjitha pikat e kontaktit/koordinatorët po bëjnë tashmë koordinim shumë më të mirë të procesit të planifikimit dhe raportimin vjetor lidhur me fondet publike të alokuara për organizatat joqeveritare nga të gjitha organizatat buxhetore në Republikën e Kosovës.

Platforma e Financimit Publik <https://ojqfinancime.rks-gov.net/> me udhëheqjen e ZQM/ZKM bashkë me ASHI-në dhe IT në ZKM iu nënshtrua një përmirësimi, funksionalizimi dhe avancimi të dukshëm. Krahas bartjes të platformës në server te ri kjo platforme po jep mundësinë e raportimin hierarkik me shumë përdorues për financimin publik të OShC-ve nga të gjitha Ministritë/ZKM/Komunat e Kosovës dhe nën njësite e tyre përkatëse. Pra, Platforma e Financimit Publik tani mundëson raportimin e financimit publik me futjen e dyfishtë të të dhënave, p.sh. përmes raportimit të drejtpërdrejtë në platformën e secilit prej projekteve të financuara nga institucionet publike ose raportimit masiv duke u mundësuar organeve publike të mbledhin të dhëna nga të gjitha nën njësite dhe në importojnë të dhënat përmes modulit të importit të platformës. Në anën e qasjes nga publiku në platformë, ka veçori të reja të filtrimit të të dhënave, si dhe grafikët ndërveprues që vizualizojnë të dhënat dhe ndihmojnë publikun të ketë një perceptim se si shpenzohen paratë publike nga secili prej institucioneve, përfituesit e OSHC-ve, territoret ku janë shpenzuar fondet, për fushat dhe aktivitetet e përgjithshme të projekteve. Gjithashtu përmirësim dhe avancim tjetër në këtë platformë që është realizuar me projektin TACSO është edhe lidhja në mes të Platformes së financimit publik të OJQ-ve dhe platformes së Donatoreve, tashmë ku i gjithë publiku mund të shohin fondet që ndahen nga donatorët për OJQ-të në Republikën e Kosovës. Zbatimi i plotë i ndryshimeve dhe reformave në platformës është arritur gjatë vitit 2023 dhe fillim vitin 2024.

Platforma ekzistuese për financimin publik të OSHC-ve edhe pse është përmirësuar dhe avancuar dukshëm, zyrtarët publik ende kanë nevojë për ngritje kapacitetesh për të zbatuar rregulloren dhe për të shfrytëzuar platformën sipas sitemit të avancuar. Ajo që vlen të përmendet në këtë fazë të raportimit është se nga MFPT tashmë është iniciuar një rishikim i rregullores aktuale të financimit publik të OJQ-ve, për të adresuar pengesat kryesore të identifikuar gjatë viteve të para të zbatimit të kësaj rregulloreje dhe lehtësimit të punës së zyrtarëve bazura në proceset e reja.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit gjatë këtij viti kemi përdorur të dhënat të përcjella prej organizatave buxhetore që kanë raportuar dhe nuk i kemi përdorur të dhëna plotësuese nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave, sepse kanë raportuar pothuaj të gjitha institucionet. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ka analizuar edhe ueb faqet e institucioneve publike, për të analizuar thirrjet publike, përmbajtjen e tyre dhe rrjedhën e procesit të një thirrje publike për financimin e OJQ-ve.

Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit nuk mbanë përgjegjësi për saktësinë e raportimeve direkte, atyre të përcjella nga organizatat buxhetore dhe as shënimeve përkitazi me emërtimet e OJQ-ve dhe detjave tjera në këto raporte.

2. TË DHËNA E PËRGJITHSHME PËR RAPORTIM NGA ANA E ORGANIZATAVE BUXHETORE

2.1 Raportimi nga Organizatat Buxhetore

Rregullorja MF-Nr.04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, tashmë me rregulla unike sa i përket financimit publik të OJQ-ve krahas obligimeve tjera përcakton në mënyrë të detajuar përgjegjësinë që institucionet publike kanë për raportimin lidhur me financimin publik të OJQ-ve.

Pra, rregullorja ka përcaktuar po ashtu rolin jo vetëm të Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit por edhe të gjitha institucioneve për procesin e përgatitjes së Raportit gjithëpërfshirës të mbështetjes financiare publike për OJQ-të. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit përgatitë raportin gjithëpërfshirës mbi bazën e raporteve të të gjitha institucioneve publike. Prandaj, forma e raportimit për mbështetjen financiare publike për OJQ-të sipas kësaj rregulloreje është shumë mirë e strukturuar duke përfshirë edhe të dhënat që duhet të përmbajë raporti vjetor. Bazuar në Nenin 26 të rregullores, të gjitha organizatat buxhetore duhet ta përgatisin raportin e tyre më së largu më 1 mars për vitin paraprak fiskal. Përveç dërgimit të këtij raporti në Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit, Organizatat buxhetore duhet të njëjtin raport ta publikojnë në faqen e internetit të institucionit përkatës.

Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë është përgjegjëse të pëmbledhë dhe të publikojë raportin gjithëpërfshirës të mbështetjes financiare Publike për OJQ-të i cili duhet të përfshijë çdo lloj mbështetje financiare që u është dhënë OJQ-ve gjatë vitit paraprak në të gjitha njësitë organizative të organizatave buxhetore në Republikën e Kosovës.

Rregullorja MF. Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, prej që është aprovuar nga Ministria e Financave, ka synuar unifikimin e procedurave për të gjithë ciklin e financimit publik të OJQ-ve. Duke filluar nga viti 2021 ne kemi mundur raportimin direkt në platformën për financim publik të OJQ-ve <http://ojqfinancime.rks-gov.net/>. Raportimi po bëhet sipas Manualit të cilin ka punuar Zyra për Qeverisje të Mirë/ Zyra e Kryeministrit/ me përkrahjen e ekspertëve të TACSO-s dhe në formatin e përcaktuar me rregullore. Mbi bazën e të gjitha raporteve të institucioneve publike, Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, ka përgatitur raportin gjithëpërfshirës të mbështetjes financiare Publike për OJQ-të në Republikën e Kosovës sipas Nenit 26 të Rregullores MF-Nr. 04/2017 edhe për vitin 2023.

Gjithësesi manuali i përgaditur ka shpjeguar dhe sqaron mundësitë dhe hapat në detaje se si zyrtarët ta përdorin platformën për të raportuar për përkrahjen financiare për OSHC-të direkt në platformën <http://ojqfinancime.rks-gov.net/>. Gjithashtu edhe këtë vit ne në mënyrë që ta lehtësojmë punën e pikave të kontaktit për raportim i kemi ndarë e përcjellë te bashkëpunëtorët edhe videot ku janë përshkruar identifikimi dhe orientimi në platforme, futja e të dhënave të raportimit dhe importimi i të dhënave. Zyra për Qeverisje të Mirë kemi krijuar e ndryshuar llogaritë për zyrtarë përgjegjës në ministri dhe komuna për qasje në Platformën e Financimeve publike për raportim dhe plotësim të tabelave direkt në platformë.

Në kërkesën për raportim, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit i ka vënë në dijeni udhëheqësit e Organizatave Buxhetore se Rregullorja, mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve MF-Nr. 04/2017, buron nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, prandaj, mos raportimi ose vonesat në raportim përbën shkelje të Dispozitave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Zyra për Qeverisje të Mirë edhe këtë vit si vitet tjera ka ofruar gjithë gatishmërinë e saj që të ofrojë ekspertizën e vet dhe ti mbështesë të gjitha

organizatat buxhetore që kanë nevojë në përgatitjen e raportit vjetor.

Krahasuar me vitet paraprake, raportimi është përmirësuar dukshëm, megjithatë, ky raport tregon se ende një numër i konsiderueshëm i institucioneve/organizatave buxhetore kanë nevojë për përkrahje dhe ngritje kapacitetesh në mënyrë që raportet e tyre ti plotësojnë kërkesat e rregullores me standardet dhe afatet e parapara tek Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit.

Figura në vijim tregon përqindjen dhe numrin e institucioneve/organizatave buxhetore përfshirë ZKM/Ministritë dhe Komunat sa i përket raportimit për financim ose jo sipas kërkesave të Rregullores MF-NR-04/2017 për Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Pjesë e përfshirjes në këtë raport janë 54 institucione/organizata buxhetore qeveritare prej të cilave: ZKM (ZKM ka katër zyra në kuadër të saj: Agjencioni për Barazi Gjinore, Zyra për Kthim e Komunitete, Komisioneri për Gjuhët dhe Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur), 15 (pesëmbëdhjetë) Ministri dhe 38 (tridhjetë e tetë) Komuna.

Nga figura më poshtë shihet se nga gjithsej 54 institucione/organizata buxhetore janë:

- 43 institucione/organizata buxhetore ose 80% që kanë raportuar,
- 07 institucione/organizata buxhetore ose 13% që nuk kanë raportuar,
- 04 organizata buxhetore ose 07 % që kanë se nuk kanë përkrahur OJQ.




Figura 1. Të dhënat e përgjithshme sa i përket raportimit nga institucionet/organizatat buxhetore për vitin 2023

Sa i përket nivelit qendror, nga figura më poshtë janë nxjerrë të dhënat për ZKM dhe ministritë ku shihet se nga gjithsej 16 organizata buxhetore janë:

- 12 organizata buxhetore ose 75% kanë raportuar dhe

- 04 organizata buxhetore ose 25 % nuk kanë përkrahur OJQ.




Figura 2. Të dhënat e përgjithshme sa i përket raportimit nga niveli qendror për vitin 2023

Ndërsa nga figura në vijm janë paraqitur të dhënat për nivelin lokal se si i janë përgjigjur kërkesës së ZQM/ZKM për të raportuar për financimin publik të OJQ-ve. Pra, nga figura më poshtë janë nxjerrë të dhënat për nivelin lokal ku shihet se nga gjithsej 38 organizata buxhetore:

- 31 organizata buxhetore ose 82 % që kanë raportuar në platformë dhe
- 07 organizata buxhetore ose 18 % që nuk kanë raportuar.




Figura 3. Të dhënat e përgjithshme sa i përket raportimit nga niveli lokal për vitin 2023

2.2 Të dhëna mbi financim publik të OJQ-ve të raportuara sipas institucioneve/organizatave buxhetore për vitin 2023

Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhënat sa i përket raportimit sipas secilit institucion/organizatës buxhetore të cilës i është kërkuar të raportoj ose ka pasur financim për OJQ-të në vitin 2023. Disa nga institucionet, kanë theksuar se nuk kanë financuar projekte të OJQ-ve ose nuk kanë shpallur thirrje publike.

Tabela 1: Të dhënat për financimin publik të OJQ-ve sipas raporteve të përcjella/raportuara nga ana e Institucioneve direkt në platformë, ato që kanë raportuar se nuk kanë ndarë fonde dhe ato që nuk kanë raportuar fare janë në tabelën në vijim:

NR.	EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE	RAPORTIMI NË ZQM BAZUAR NË RREGULLOREN MF-04/2017
I	ZYRA E KRYEMINISTRIT	1. Agjencia për Barazi Gjinore kanë raportuar se gjatë vitit 2023 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare 2. Zyra e Komisionerit për Gjuhët, kanë raportuar në platformë 3. Zyra për Komunitete kanë raportuar në platformë 4. Zyra e Komisionerit për Persona të Pagjetur kanë raportuar gjatë vitit 2023 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare (ose kanë përkrahur me më pak se 500 euro)
MINISTRITË E LINJËS		
1.	MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL	MAPL kanë raportuar në platformë
2.	MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT	MASHTI kanë raportuar në platformë
3.	MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	MBPZHR kanë raportuar se gjatë vitit 2023 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
4.	MINISTRIA E DREJTËSISË	MD kanë raportuar në platformë
5.	MINISTRIA E FINANCAVE PUNËS DHE TRANSFEREVE	MFPT kanë raportuar në platformë
6.	MINISTRIA E MBROJTJES	MM kanë raportuar në platformë
7.	MINISTRIA MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPSIONR DHE INFRASTRUKTURËS	MMPHI kanë raportuar se gjatë vitit 2023 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
8.	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MKRS kanë raportuar në platformë
9.	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	MPB kanë raportuar se gjatë vitit 2023 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
10.	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS	MPJD kanë raportuar në platformë
11.	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	MSH kanë raportuar në platformë
12.	MINISTRIA E EKONOMISË	ME kanë raportuar në platformë
13.	MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL	MZHR kanë raportuar në platformë
14.	MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM	MKK kanë raportuar në platformë
15.	MINISTRIA E INDUSTRIËS, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË	MINT kanë raportuar se nuk ka pasur financim të OJQ-ve gjatë vitit 2023

KOMUNAT

1.	KOMUNA E DEÇANIT	Komuna e Deçanit nuk kanë raportuar
2.	KOMUNA E DRAGASHIT	Komuna e Dragashit kanë raportuar në platformë
3.	KOMUNA E FERIZAJIT	Komuna e Ferizajt kanë raportuar në platformë
4.	KOMUNA E GJAKOVËS	Komuna e Gjakovës nuk kanë raportuar në 2023
5.	KOMUNA E GJILANIT	Komuna e Gjilanit kanë raportuar në platformë
6.	KOMUNA E DRENASIT	Komuna e Drenasit kanë raportuar në platformë
7.	KOMUNA E GRAÇANICËS	Komuna e Graçanicës kanë raportuar në platformë
8.	KOMUNA E HANIT TË ELEZIT	Komuna e Hanit të Elezit kanë raportuar në platformë
9.	KOMUNA E ISTOGUT	Komuna e Istogut kanë raportuar në platformë
10.	KOMUNA E JUNIKUT	Komuna e Junikut kanë raportuar në platformë
11.	KOMUNA E KAÇANIKUT	Komuna e Kaçanikut kanë raportuar në platformë
12.	KOMUNA E KAMENICËS	Komuna e Kamenicës kanë raportuar në platformë
13.	KOMUNA E KLINËS	Komuna e Klinës kanë raportuar në platformë
14.	KOMUNA E KLLOKOTIT	Komuna e Kllokotit nuk kanë raportuar
15.	KOMUNA E LEPOSAVIQIT	Komuna e Leposaviqit kanë raportuar në platformë
16.	KOMUNA E LIPJANIT	Komuna e Lipjanit kanë raportuar në platformë
17.	KOMUNA E MALISHEVËS	Komuna e Malishevës nuk kanë raportuar
18.	KOMUNA E MAMUSHËS	Komuna e Mamushës kanë raportuar në platformë
19.	KOMUNA E MITROVICËS SË VERIUT	Komuna e Mitrovicës Veriore nuk kanë raportuar
20.	KOMUNA E MITROVICËS	Komuna e Mitrovicës nuk kanë raportuar
21.	KOMUNA E NOVO BËRDËS	Komuna e Novo Bërdës kanë raportuar në platformë
22.	KOMUNA E OBILIQIT	Komuna e Obiliqit kanë raportuar në platformë
23.	KOMUNA E PARTESHIT	Komuna e Parteshit nuk kanë raportuar

24.	KOMUNA E PEJËS	Komuna e Pejës kanë raportuar në platformë
25.	KOMUNA E BESIANËS/PODUJEVES	Komuna e Podujevës kanë raportuar në platformë
26.	KOMUNA E PRISHTINËS	Komuna e Prishtinës kanë raportuar në platformë
27.	KOMUNA E PRIZRENIT	Komuna e Prizrenit kanë raportuar në platformë
28.	KOMUNA E RAHOVECIT	Komuna e Rahovecit kanë raportuar në platformë
29.	KOMUNA E RANILLUGUT	Komuna e Ranillugut kanë raportuar në platformë
30.	KOMUNA E SHTËRPCËS	Komuna Shtërpcës kanë raportuar në platformë
31.	KOMUNA E SHTIMES	Komuna e Shtimes kanë raportuar në platformë
32.	KOMUNA E SKENDERAJT	Komuna e Skenderajt kanë raportuar në platformë
33.	KOMUNA E THERANDËS/SUHAREKËS	Komuna e Therandës/Suharekës kanë raportuar në platformë
34.	KOMUNA E VITISË	Komuna e Vitisë kanë raportuar në platformë
35.	KOMUNA E VUSHTRRISË	Komuna e Vushtrrisë kanë raportuar në platformë
36.	KOMUNA E ZUBIN POTOKUT	Komuna e Zubin Potokut kanë raportuar në platformë
37.	KOMUNA E ZVEÇANIT	Komuna e Zveçanit kanë raportuar në platformë
38.	KOMUNA E FUSHË KOSOVËS	Komuna e Fushë Kosovës kanë raportuar në platformë

3. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË NË NIVEL TË MINISTRIVE, KOMUNAVE DHE ZYRËS SË KRYEMINISTRIT PËR 2023

Institucionet e nivelit qendror dhe lokal edhe gjatë vitit 2023 kanë vazhduar mbështetjen e projekteve dhe aktiviteteve të Organizatave jo-qeveritare duke përfshirë financimin e projekteve specifike apo përkrahjes direkte për OJQ-të. Pra, nga ky raport dhe këto të dhëna të mbledhura e të përpunuara mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin 2023, mund të konstatojmë se bashkëpunimi me organizatat jo qeveritare në realizimin e prioriteteve të qeverisë në fusha të ndryshme ka vazhduar edhe gjatë vitit 2023.

Nga analiza e të dhënave të dorëzuara nga vetë institucionet dhe të dhënave nga platforma për financim <http://ojqfinancime.rks-gov.net> për vitin 2023 rezulton se mbështetja financiare publike për OJQ-të nga institucionet publike përfshirë nivelin qendror dhe lokal është €14,400,877.04. Bazuar te pasqyra në platformën për financim publik të OJQ-ve € 8,541,619.96 ose 59% e shumës së përgjithëshme janë ndarë nga niveli qendror ndërsa € 5,859,258.08 ose 41 % janë ndarë nga niveli lokal.




Figura 4. Të dhëna të përgjithshme për financimin publik të OJQ-ve sipas raporteve të marra nga institucionet/organizatat buxhetore për 2023

Nga të dhënat si më poshtë mund të shihet përafërsisht cilat fusha kanë marrë më së shumti fonde ose janë përkrahur nga ana e institucioneve të nivelit qendror nga ZKM dhe Ministritë e të cilat janë: shërbime sociale 12.69%; arti dhe kultura 40.57%; arsim, shkencë dhe hulumtim 5.34 %; shëndeti 1.50%, e pacaktuar dhe fusha tjera 33.39%.

Fushat e financimit të projekteve të OJQ-ve nga ZKM dhe Ministritë për vitin 2023




Figura 5. Fushat e financimit të Projekteve të OJQ-ve nga ZKM/Ministritë për vitin 2023 në % përqindje të përafërt të financimit sipas të dhënave nga platforma për financim

Ndërsa në figurën më poshtë pasqyrohen fushat e financimit të Projekteve të OJQ-ve nga Komunitatet për vitin 2023 në % përqindje të përafërt të financimit, gjithmonë sipas të dhënave dhe raportimit të komuniteteve të platforma për financim.

Në figurën më poshtë nga ana e nivelit lokal fushat që janë përkrahur janë: sporti 24.86 % e fondeve; shërbime sociale 5.08 %; arti dhe kultura 23 %; shëndeti 1.67 %; arsim, shkencë dhe hulumtim 3.10%, e pacaktuar dhe fusha tjera 41.94 %.

Fushat e financimit të projekteve nga komunat në % të përafërt për vitin 2023




Figura 6. Fushat e financimit të Projekteve të OJQ-ve nga Komunat për vitin 2023 në % përqindje të përafërt të financimit sipas të dhënave nga platforma për financim

Në figurën më poshtë janë paraqitur dhe pasqyruar të dhënat e përafërta për financimin publik të OJQ-ve për vitin 2023 sipas platformës dhe raportimit instiucional për ZKM/ Ministrinë /Komunat dhe Donatorët Ndërkombëtar.

Totali i shumës së fondeve të ndara për OSHC-të nga ZKM /Ministrinë/Komunat dhe Donatorët Ndërkombëtar është € 15,014,822.62. Nga e gjitha kjo shumë Zyra e Kryeministrit dhe Ministrinë kanë ndarë € 8,541,619.96, Komunat kanë ndarë €5,859,258.08, ndërsa Donatorët Ndërkombëtar kanë ndarë € 613,945,58.




Figura 7. Të dhënat mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin 2023 sipas platformës për ZKM/Ministritë/Komunat dhe DonatorëtNdërkombëtar

Të dhënat për numrin e projekteve të finanacuara për OJQ-të për vitin 2023 sipas platformës online nga ZKM/Ministritë si dhe për Komunat janë paraqitur në figurën më poshtë. Totali i numri të projekteve të OJQ-vë që janë përkrahur gjatë vitit 2023 nga ZKM/Ministritë dhe Komunat është 1858 projekte për OJQ-të. Nga ky numër të dhënat për numrin e projekteve të OJQ-ve nga ZKM/Ministritë janë 599 projekte, ndërsa nga ana e Komunave për vitin 2023 janë financuar 1259 projekte.




Fig 8. Të dhënat për numrin e projekteve që janë ndarë për OJQ-ve nga ZKM/Ministritë për vitin 2023




Fig 9. Të dhënat për numrin e projekteve që janë ndarë për OJQ-ve nga ZKM/Ministrinë për vitin 2023

Nga ky numër të dhënat për numrin e projekteve të OJQ-ve nga ana e Komunave të Republikën e Kosovës për vitin 2023 janë financuar 1259 projekte. Në figurën më poshtë janë paraqitur të dhënat për numrin e projekteve që janë ndarë për OJQ-ve nga Komunitatet për vitin 2023.




Fig 10. Të dhënat për numrin e projekteve që janë ndarë për OJQ-ve nga Komunitatet për vitin 2023

Në figurën më poshtë janë paraqitur të dhënat krahasuese për financimin publik të OJQ-ve për vitet 2023 dhe 2022, pra janë krahasur të dhënat e raportuara nga institucionet publike për numrin e projekteve të financuara sipas platformës online për ZKM/Ministritë si dhe për Komunitatet.




Figura 11. Të dhënat krahasuese për financimin publik të OJQ-ve për vitet 2023 dhe 2022 për ZKM/Ministritë dhe Komunat sipas platformës për financim

Nga të dhënat krahasuese krahasuese për numrin e përfituesve (OJQ-ve) nga ZKM/Ministritë dhe Komunat për vitin 2022 dhe 2023 , pra janë krahasur të dhënat e raportuara nga institucionet publike gjithmonë sipas platformës online për ZKM/Ministritë si dhe për Komunat.

Gjatë vititi 2023 vërehet ngritje e konsiderueshme e përkrahjes për numër të OJQ-vë pra projekte përfituesve. Në nivel të ministrive përdorisa gjatë vititi 2022 numri i projekteve ka qenë 435 në vitin 2023 është 599, ndërsa në nivel të Komunave në vitin 2022 ka qenë 1060 dhe në vitin 2023 është 1259 projekte. Totali për numër të përfituesve për projekte nga OJQ-të është në vitin 2022 është 1495 projekte të OJQ-ve ndërsa në vitin 2023 është 1858 organizata joqeveritare ose projekte që janë ndarë dhe janë raportuar.

Qëllimi i mbështetjes financiare të ofruar nga Zyra e Kryeministrit, Ministritë dhe Komunat

Raporti mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të që përgatitet nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit përfshinë informacione mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të, ofruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministritë dhe Komunat për përkrahjen e projekteve të Organizatave Jo-Qeveritare në fusha të ndryshme, të ndërlidhura me prioritet e Institucioneve të Republikës së Kosovës dhe shoqërisë kosovare. Raportet mbulojnë të dhënat për të gjitha organizatat buxhetore të nivelit qendror dhe lokal të cilat në çfarëdo forme kanë ofruar mbështetje financiare për organizatat jo qeveritare.

Procesi i raportimit për financimin e OJQ-ve është avancuar në vazhdimësi, pra jo vetëm duke e hartuar dhe aprovuar rregulloren, duke e krijuar dhe lansuar platformën për financim, por duke e mundur edhe raportimin direkt të institucioneve në platformën për financim publik të OJQ-ve <http://ojqfinancime.rks-gov.net> . Raportimet janë bërë duke ju përshtatur përafërsisht planeve vjetore të financimit por ka hapsirë për mirësimi sepse financimet ende nuk janë shumë korrekt dhe në linjë

[me planet vjetore të financimit](#). Janë gati të gjitha Ministritë, Komunat dhe zyrat në kuadër të Zyrës së Kryeministrit që kanë raportuar direkt në platformën online <http://ojqfinancime.rks-gov.net/> për ndarjen e fondeve për OJQ-të dhe institucionet që nuk kanë ndarë fonde. Gjithmonë edhe te ky raportim pa i llogaritur në detaje raportet jo të kompletuara ose lëshimet teknike për këtë ndarje fondesh, mirëpo ajo që duhet të theksohet është përmirësimi me progres mjaft të dukshme në këtë aspekt.

Raportimi bëhet sipas Manualit i cili shpjegon dhe sqaron mundësitë dhe hapat në detaje se si ta përdorim platformën për të raportuar për përkrahjen financiare për OSHC-të direkt në platformën për financim <http://ojqfinancime.rks-gov.net/>. Mbi bazën e të gjitha raporteve të institucioneve publike, Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, përgatit raportin gjithëpërfshirës të mbështetjes financiare publike për OJQ-të në Republikën e Kosovës sipas Nenit 26 të Rregullores MF-Nr. 04/2017.

Ne si zyrë në mënyrë që ta lehtësojmë punën e pikave të kontaktit për raportim i kemi përgaditur, ndarë e përcjellë te bashkëpunëtorët edhe videot ku janë përshkruar identifikimi dhe orientimi në platforme, futja e të dhënave të raportimit dhe importimi i të dhënave. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit kemi krijuar e ndryshuar llogaritë për shumë zyrtarë përgjegjës në ministri e komuna për qasje në Platformën e Financimeve publike për raportim dhe plotësim të tabelave direkt në platformë. Po ritheksojmë se procesi i raportimit për financimin e OJQ-ve është avancuar në vazhdimësi, pra jo vetëm duke e krijuar dhe lansuar platformën për financim, por duke e mundësuar edhe raportimin direkt në platformën për financim publik të OJQ-ve. Me një kërkim të lehtë në platformën online mund të gjinden të dhënat për mbështetjen financiare publike për OSHC-të sipas viteve, institucioneve, OJQ-ve, etj. Rregullorja ka përcaktuar po ashtu rolin jo vetëm të Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit por edhe të gjitha institucioneve për procesin e përgatitjes së Raportit gjithëpërfshirës të mbështetjes financiare publike për OJQ-të.

Përgatitja e raportit gjithëpërfshirës vjetor të mbështetjes financiare publike për OJQ-të për vitin 2023 përfshijnë atë që :

1. Secili ofrues i mbështetjes financiare publike pasi të përgatis raportin vjetor sipas nenit 25 të kësaj Rregulloreje, do t'i dërgojnë një kopje elektronike të raportit Zyrës së Kryeministrit, përkatësisht Zyrës përkatëse për Qeverisje të Mirë, më së largu deri më 1 mars.
2. Zyra e Kryeministrit, mbi bazën e raporteve të pranuar nga secili ofrues i mbështetjes financiare publike përgatit raportin e përgjithshëm vjetor të mbështetjes financiare publike për OJQ-të në Republikën e Kosovës më së largu deri më 31 mars .

Sipas rregullores, këto raporte do të duhej të përfshijnë ndër të tjera:

- ✓ Emrin e ofruesit të mbështetjes financiare publike (Ministrisë, komunës, agjencisë duke përfshirë programet specifike në kuadër të të cilave ofrohet mbështetja financiare publike);
- ✓ Mënyrën e alokimit të mbështetjes financiare publike (përmes thirrjes/kontraktim direkt);
- ✓ Thirrjen publike përmes të cilës është ofruar mbështetja financiare;
- ✓ Emrin e plotë të përfituesve të mbështetjes financiare (duke përfshirë edhe të dhënat tjera të përfituesit, adresën, numrin e regjistrimit dhe numrin fiskal dhe të dhënat për personin përgjegjës të OJQ-së;
- ✓ Emërtimin e projektit/programit apo aktiviteteve të financuara;
- ✓ Shumën e dhënë për financimin e projektit/programit;
- ✓ Kohëzgjatjen e projektit dhe statusin e zbatimit të tij;

- ✓ Fushat e përgjithshme dhe specifike të financimit;
- ✓ Përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë;
- ✓ Aktivitetet apo shërbimet kryesore të realizuara në kuadër të projektit;
- ✓ Të dhënat gjeografike sa i përket vendit të implementimit të projektit;
- ✓ Numrin e personave që kanë përfituar apo janë punësuar në kuadër të projektit/programit.

Gjithashtu për qëllim të raportimit standard duhet të përdoret formulari F20, i cili është pjesë përbërëse e rregullores, manualit dhe tash e platformës për financim <http://ojqfinancime.rks-gov.net>. Tani me avancimin e platformës, koordinatorëve ju është krijuar mundësia dhe po raportojnë direkt në platformë. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit përgatitë raportin gjithëpërfshirës mbi bazën e raporteve të gjitha institucioneve publike.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në përputhje me kërkesat e Rregullores, MF-Nr. 04/2017, mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe për zbatim sa më efektiv të kësaj rregulloreje ka themeluar një mekanizmi të përhershëm i cili po koordinon punën e planifikimit dhe raportimit vjetor për financimin e organizatave jo-qeveritare në kuadër të secilës ministri dhe komunë. Pra, me qëllim të avancimit të procesit të raportimit dhe një qasjeje gjithëpërfshirëse për zbatim të Rregullores MF-Nr. 04/2017, janë caktuar pika kontakti (koordinator) për komunikim dhe koordinim me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit në procesin e raportimit, zyrtarët që janë caktuar nga Ministritë e Komunitetit janë rekomanduar të jenë nga departamentet e buxhetit dhe financave ose zyrtarë që merren me zbatimin dhe monitorimin e projekteve dhe programeve të financimit publik të OJQ-të.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, me qëllim të informimit e njohjes me procesin dhe procedurat për zbatimin e Rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, për aplikimin e rregullores, ka realizuar sesione të përbashkëta informuese dhe takime e ngritje kapaciteteve për zyrtarë përgjegjës/koordinatorët e caktuar.

Zyrtarët përgjegjës (koordinatorët) për këtë proces janë caktuar nga të gjitha ministritë, nga Zyra e Kryeministrit, si dhe nga 35 komunat përgjegjëse.

Përfitimet institucionale nga përkrahja e financimit publik të OJQ-ve

Vlerësojmë se jo vetëm qytetarët por edhe ministritë dhe komunat përfitojnë nga ky financim në mënyra të ndryshme dhe shumë të vleshme për neve si institucione publike dhe punën tonë të përditëshme. Duam të veçojmë përfitimet tona si institucione në këtë përkrahje:

- Ndihma për zbatimin e politikave publike: financimi i organizatave joqeveritare mund dhe po përdoret për të mbështetur zbatimin e politikave dhe strategjive të qeverisë në fusha të ndryshme si arsim, shëndetësi, zhvillim ekonomik dhe mbrojtje të mjedisit.

-Ndërtimi i kapaciteteve të shërbyesve civil: organizatat joqeveritare mund dhe po ofrojnë trajnime dhe asistencë teknike për zbatimin e politikave dhe për të ndihmuar në forcimin e kapaciteteve të personelit të ministrive dhe komunave për të përmbushur qëllimet e tyre.

-Monitorimi dhe vlerësimi i politikave: përmes financimit të organizatave joqeveritare, ministritë dhe komunat mund dhe po sigurojnë monitorimin dhe vlerësimin më të qëndrueshëm të efikasitetit dhe impaktit të politikave dhe programeve të tyre.

-Përfaqësimi dhe konsultimi publik i komunitetit: organizatat joqeveritare kanë një lidhje të ngushtë me komunitetin e mund dhe po shërbejnë si zëdhënës instiucional në proceset e politikëbërësve dhe të vendimmarrjes, duke përmirësuar transparencën dhe pjesëmarrjen në bërjen e këtyre politikave.

- Inovacion dhe eksperimentim: financimi i organizatave joqeveritare mund dhe duhet të lejojë ministrinë dhe komunat të eksperimentojnë me modele të reja të shërbimeve dhe programeve që të ofrojnë zgjidhje inovative për sfidat tona të përbashkëta.

4. TË DHËNA PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË SIPAS ZKM, MINISTRIVE DHE KOMUNAVE

4.1 Të dhënat e përgjithshme për financimin publik të OJQ-ve për vitin 2023 sipas raportimit nga ZKM dhe Ministrinë

Në tabelën në vijim janë të përfshira raportet/të dhënat sipas ZKM, Ministrive të Linjës dhe Komunave. Shuma e përfshinë të gjitha pagesat e kryera gjatë vitit fiskal nga data 1 janar 2023 deri më 31 dhjetor 2023. Këto të dhëna janë të ndërlidhura me raportin e instiucioneve/organizatave buxhetore dhe përfshijnë listën e përfituesve.

NR.	EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE	Shuma e dhënë nga institucionet për OJQ gjatë vitit 2023 (Euro)
	<u>ZKM</u>	
<u>I.</u>	Zyra e Kryeministrit	449,000 EUR
	<u>Ministrinë</u>	
1.	MKRS- Ministria e Kultures Rinise dhe Sportit	3,801,628 EUR
2.	MM- Ministria e Mbrojtjes	279,480 EUR
3.	MFPT- Ministria e Financave, Punes dhe Transfereve	856,667 EUR
4.	ME- Ministria e Ekonomise	27,715 EUR
5.	MASHTI	369,980 EUR
6.	MZHR- Ministira e Zhvillimit Rajonal	361,380.00 EUR
7.	MPJD- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	398,600.00 EUR
8.	MD- Ministria e Drejtësisë	1,497,000.00 EUR
9.	MSH- Ministria e Shëndetësisë	77,840.00 EUR
10.	MAPL- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	148,724.70 EUR
11.	MKK- Ministria për Komunitete dhe Kthim	273,605 EUR
12	MBPZHR-Ministria e Bujqësisë, Pyllatrisë dhe Zhvillimit Rural	Kanë raportuar se nuk kanë përkrahur OJQ
13	MINT- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	Kanë raportuar se nuk kanë përkrahur OJQ
14	MPB- Ministria e Punëve te Brendshme	Kanë raportuar se nuk kanë përkrahur OJQ
15	MMPHI- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe	Kanë raportuar se nuk kanë përkrahur

	Infrastrukturës	OJQ
	KOMUNAT	
1.	Komuna Dragash	139,800 EUR
2.	Komuna Ferizaj	140,000 EUR
3.	Komuna Drenas/Glllogoci	213,832 EUR
4.	Komuna Gracanice	298,474 EUR
5.	Komuna Kacanik	74,800 EUR
6.	Komuna Kamenice	3,500.00 EUR
7.	Komuna Lipjan	140,390 EUR
8.	Komuna Artanë/Gjilan	233,640 EUR
9.	Komuna Obiliq	266,595 EUR
10.	Komuna Prishtinë	2,058,624 EUR
11.	Komuna Prizren	1,053,330 EUR
12.	Komuna Skenderaj	3,500.00 EUR
13.	Komuna Therandë/Suharekë	2,500.00 EUR
14.	Komuna Viti	2,000 EUR
15.	Komuna Besianës/Podujevë	126,200 EUR
16.	Komuna Vushtri	2,000.00 EUR
17.	Komuna Istog	226,361 EUR
18.	Komuna Gjakovë	00. Nuk kanë raportuar
19.	Komuna Fushë Kosovë	61,900 EUR
20.	Komuna Hani i Elezit	22,000 EUR
21.	Komuna Shtime	100,290 EUR
22.	Komuna Junik	18,013 EUR
23.	Komuna Klinë	63,300 EUR
24.	Komuna Mitrovicë	00. Nuk kanë raportuar
25.	Komuna Malishevë	00. Nuk kanë raportuar
26.	Komuna Rahovec	4,000.00 EUR
27.	Komuna e Novo Bërdës	97,246 EUR
28.	Komuna e Pejës	313,700 EUR
29.	Komuna e Parteshit	5,000.00 EUR
30.	Komuna Mitrovica Veriore	00. Nuk kanë raportuar
31.	Komuna e Zveçanit	20,000 EUR
32.	Komuna e Zubin Potokut	15,000 EUR
33.	Komuna e Deçanit	00. Nuk kanë raportuar
34.	Komuna e Klllokotit	00. Nuk kanë raportuar
35.	Komuna e Shtërpces	3,500.00 EUR
36.	Komuna e Raniillukës	3,500.00 EUR
37.	Komuna e Leposavicit	00. Nuk kanë raportuar
38.	Komuna e Mamushes	4,000.00 EUR

4.2 Mbështetja Financiare për OJQ-të në kuadër të ZKM dhe MINISTRIVE për vitin 2023 krahasur me vitin 2022

Sipas raporteve që i kemi pranuar nga institucionet në vitin 2023 vërehet një ngritje e financimit të numrit të OJQ-ve dhe projekteve. Të dhënat e paraqitura në vijim tregojnë shumën e mbështetjes financiare publike për OJQ-të sipas raporteve të pranuara nga ministritë përkatëse e cila është dhënë në vitin 2023 dhe e njëjta është krahasuar edhe me vitin paraprak 2022.

Nëse i analizojmë të dhënat e mbështetjes financiare publike, mund të konstatojmë se sa i përket shumës së mbështetjes financiare, institucionet që më së shumti kanë përkrahur projektet e OJQ-ve janë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, MZHR, ZKM, MD dhe Zyra e Kryeministrit. Në figurën janë paraqitur të dhënat sipas raportimit të institucioneve te platforma për financim për mbështetjen financiare publike për OJQ-të, për shumat e dhëna nga Zyra e Kryeministrit, Ministritë dhe Komunat për vitin 2022 dhe 2023.

Të dhënat krahasuese për financim publik të OJQ-ve për vitet 2022 dhe 2023 nga ZKM dhe Ministritë





Figura 12. Të dhënat krahasuese për financim publik të OJQ-ve për vitet 2022 dhe 2023 nga ZKM dhe Ministritë

Të dhënat krahasuese për financim publik të OJQ-ve për vitet 2022 dhe 2023 nga Komunat



	2022	2023
Dragash	€ 139,800.00	€ 86,180.00
Ferizaj	€ 140,000.00	€ 169,008.00
Fushë Kosovë	€ 61,900.00	€ 24,300.00
Gjakovë	€ -	€ 165,350.00
Gjiilan	€ 233,640.00	€ 199,654.00
Drenas	€ 213,832.15	€ 121,379.65
Graçanicë	€ 298,473.50	€ 232,471.44
Hani i Elezit	€ 22,000.00	€ 14,000.00
Istog	€ 226,360.50	€ 209,427.00
Junik	€ 18,012.60	€ 81,419.00
Kaçanik	€ 74,800.00	€ 68,350.00
Kamenicë	€ 3,500.00	€ 175,827.00
Klinë	€ 63,300.00	€ 2,000.00
Lipjan	€ 140,390.00	€ 147,000.00
Mamushë	€ 4,000.00	€ -
Mitrovicë	€ -	€ 19,300.00
Malishevë		€ 18,000.00
Novobërdë	€ 239,510.05	€ -
Obiliq	€ 266,595.00	€ 57,300.00
Partesh	€ 5,000.00	€ -
Pejë	€ 313,700.00	€ -
Podujevë	€ 126,200.00	€ 94,400.00
Prishtinë	€ 2,058,624.28	€ 804,667.00
Prizren	€ 1,053,330.00	€ 605,025.00
Rahovec	€ 4,000.00	€ -
Ranillugë	€ 3,500.00	€ -
Shtërpce	€ 3,500.00	€ -
Shtime	€ 100,290.00	€ 115,101.00
Skenderaj	€ 3,500.00	€ 98,350.00
Suharekë	€ 2,500.00	€ 55,200.00
Viti	€ 2,000.00	€ -
Vushtrri	€ 2,000.00	€ 337,309.00
Zveçan	€ 20,000.00	€ -
Zubin Potok	€ 15,000.00	€ -

Figura 13. Të dhënat krahasuese për financim publik të OJQ-ve për vitet 2022 dhe 2023 nga Komunitat

4.3. Mbështetja në kuadër të ZKM dhe Ministrive

